

Termet e Referencës: Ekspert për ofrimin e një programi të quajtur "Ditët e shkencës në park"

1. Hyrje

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, përmes Grantit PONT në Parkun Kombëtar të Alpeve Shqiptare (PA_028), duke ndjekur planin operacional të dakordësuar për këtë zonë të mbrojtur, është e angazhuar në monitorimin dhe ruajtjen e specieve treguese si një komponent kyç i menaxhimit të përgjithshëm të zonës së mbrojtur së bashku me habitatet kryesore. Për të siguruar efektivitetin e përpjekjeve tona për ruajtje, ne po kërkojmë një ekspert me përvojë për të ofruar një program të quajtur "Ditët e shkencës në park".

2. Objektivat

Objektivat kryesore të angazhimit të ekspertit janë si më poshtë:

a. Të realizojë një program të quajtur "Ditët e shkencës në park".

3. Qëllimi

Eksperti do të jetë përgjegjës për:

Ofrimin e 12 ditëve të programit të quajtur "Ditët e shkencës në park" në Parkun Kombëtar të Alpeve Shqiptare, që do të ndihmojë AdZM-të e Shkodrës dhe Kukësit ta zbatojnë atë në të ardhmen si pjesë e programit.

4. Kohëzgjatja

Konsulenca pritet të fillojë më 25 korrik dhe të përfundojë më 1 shtator. Shumica e punës do të kryhet në Shkodër dhe Kukës. Eksperti pritet të ofrojë një program të quajtur "Ditët e shkencës në park", që përmban module trajnimi dhe informacion në lidhje me Parkun Kombëtar të Alpeve Shqiptare.

5. Raportimi

Eksperti do të dorëzojë një raport mbi aktivitetet tek Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura së bashku me rekomandimet.

6. Kualifikimi

Kandidati duhet të ketë:

- 5 - 10 vite përvojë në fushën e ekspertizës së biodiversitetit dhe ndërgjegjesimit publik
- Ekspertizë të dëshmuar në përbërjen e habitatit dhe specieve të Parkut Kombëtar të Alpeve Shqiptare
- Njohuri me kontekstin ekologjik të zonës së projektit.

7. Buxheti

Buxheti për konsulencën referohet linjave të buxhetit:

- Aktiviteti Nr. 4.1 "Ditët e shkencës në park" Duke bërë vlerën totale të kësaj konsulence 3000 Euro duke përfshirë 15% të taksave.

8. Procesi i Aplikimit dhe Afati

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë një CV deri më 22 korrik 2024 në adresën info@akzm.gov.al